

## GJURMË ETNOKOREOGRAFIKE NGA NJË EKSPEDITË NË DUKAGJIN TË SHKODRËS

Për të studiuar pasuritë folklorike të rrethinave të Shkodrës, gjatë periudhës 16 tetor-5 nëntor 1972, u organizua nga Instituti i Folklorit (sot Instituti i Kulturës Popullore pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë) një *ekspeditë kërkimore shkencore* për probleme të folklorit nga fusha e prozës dhe e poezisë popullore, nga muzika dhe koreografia popullore. Gjurmimet e ekspeditës u përqëndruan edhe në zonën e Dukagjinit, që shquhet për një folklor autentik, i cili ka hedhur dritë në etnogjenezën e artit tradicional të asaj bashkësie dhe në pasqyrimin e kulturës popullore kombëtare në rrafsh etnik. Grupi i ekspeditës u përqëndrua kryesisht në fshatrat Breglum dhe Theth. Ai përbëhej nga Qemal Haxhihasani, bashkëpunëtor i vjetër shkencor (i cili, si përgjegjës i ekspeditës, dha ndihmesë të çmuar në organizimin dhe drejtimin e punës kërkimore-shkencore), nga Ramazan H. Bogdani, Feral Daja, Miranda Dule, Ahmet Shehu, Gavrosh Haxhihyseni, Fatmir Vaqarri, si dhe Kol Shtjefni, që u caktua nga rrethi i Shkodrës si shoqërues për Dukagjinin. Ekspedita ishte e pajisur me mjete teknike të domosdoshme për regjistrime muzikore, filmike, fotografike etj.

Në Dukagjin zhvilluam takime pune me bartësit: *Lina Dedja* nga fshati Lotaj, *Nik Pal Nika* nga Lekaj, *Marash Nou* nga Lekaj, *Zef Gjeloşi* nga Lotaj, *Lazar Bregu* nga Breglumi, *Prena Lulja* nga Lotaj, *Ded Nue Gila* nga Abati, *Gjergj Mark Lulashi* nga Nicaj-Shosh, *Kol Zef Kroni* nga Palaj, *Gjelosh Ara* nga Ndrecaj, *Shkurte Rushetja* nga Lekaj etj.

Lidhur me fushën e etnokoreografisë të krahinës së Dukagjinit, gjatë ekspeditës arritëm të mbledhim të dhëna për kërcimet, si edhe të vjelim një lëndë me karakter folklorik, etnografik, historik dhe më gjerë në dobi të punës sonë studimore. Gjithashtu, realizuam katër filmime vallesh, tri regjistrime bisedash në magnetofon si dhe zhvilluam disa fotografime me pamje kërcimesh etj.

Sipas njohurive tona para ekspeditës, por edhe gjatë atyre kërkimeve, ishim të vetëdijshëm se në Dukagjin, në të kaluarën vallet janë luajtur më pak se në çdo krahinë ose zonë të vendit tonë. Kjo ka ndodhur veçanërisht te gratë. *"Gruaja dukagjinese as ka knue, as ka kcye ner dasma"*, tregojnë vendasit.

Për një informacion më të gjerë në këtë aspekt, do t'i referohemi dy subjekteve, paçka se dëshmitë e tyre janë edhe me përshkrime detajesh për ceremonialin e dasmës, por edhe më gjerë. Këtë lëndë po e paraqesim sipas shënimeve tona (tetor, 1972), por duke ruajtur dialektin dhe rrjedhshmërinë e tregimeve sipas vetë subjekteve:

*Lina Dedja*. 60 vjeçe, nga fshati Lotaj (Shalë), martuar në Gimaj:

*"Grat' n'dasma nuk knojkin, as kcejkin n 'at koh! Martesa u zijke qysh n'vogli, ose pa u le fare. Me mor nusen, shkojkin dy dasmaresha. Ato merken një dhi, ene krahen, pasqyr, duvak ... (njaso senesh). Dasmareshat flejken një nat'atje; u preke dhia e u bojkë dasem. Masanej shkojkin n'pun' t'vet. Nusen e percillken me vaj e jo me dajre. Nusja dilke tuj duhat me zo t'nolt, ene grat' e shpis kjajkin. Burrat thojkin: "Fali zot nafaken e vet", "T'rujt zoti koke". Nusen, t'mulume me duvak, e merrken vetem dy dasmareshat (me qen dimen vijken ene burra dasmor) ene e bijken n'"Orok". Deri k'tu nusen e percillken gjinia e vet. N'"Orok" vijken 8-9 burra t'nahis dhandrit ene e merrken nusen. Nusja me dy dasmareshat eckin gjithmon n'kom. Me pas hyp nusja n'kal, kishte me nodh marr e madhe. Dasmorët nishkin kanget; kang t'shkurtina, "maje krahit", qi t'merrke vesh mileti se po vin nusja. Para shpis nusen e pritken varg njerezish t'dhanrrit. Para derës shpis' nusen e merrke xheveri (një kushuri i par' i dhanrrit) ene e sillke tri her' rreth një sofër. Sa her e sillke, qitshin kaj pushk'. Kur hyjke nusja n'shpi, i bojkin disa adete... Masanej, kur burrat u shtrojkën e nishkin kanget ene lojna kapuçash, nusen, t'mulume me duvak, e merrkin dy dasmareshat ene e çojkin n'od' t'grave. N'adje u zbulojke nusja. Dasma u bojke deri nesre mesdit. Burrat gjujkin shej me mavzere. Ama, dajret ne grat' nuk i njifikim fare; ashtu si ban bum-bum-bum, sa asht jeta, s'e kem pas' pa e ni noj her. Pushka e shperdake dasmen... N'krye. t'tri javve ardhke gjinia e merke nusen qi e majke disa dite. Prap e merke gjinia e dhanrrit".*

*Zef Gjeloši*. 92 vjeç, nga fshati Lotaj (Shalë):

*"Kam mar pjes n'luft me Ded Gjo Lulin e Mehmet Shpendin. E kam luft' gjithmon gishtin. I kam pas ra ene lahutes, ama për t'knu nuk kam k'nu. N'Dukagjin kena luft lahuten, fyllin, zumaren; çitelin mo von. N'dasma kina pi shum raki, kina luft "kapuçat", ene gjujkim shej me mavzere. Nuk kena kcyë kurr'. Kurr' n 'dynja s'ka pas tupan n'Dukagjin. Grat' si kan' pa ra dajres, ene s'kan knu. Vetem per deke vajtoken grat. Me pas knue gruja, ma par' e kishe lshu. Neve Shala me Nikajt e Mertur kina dhan e kina mar, ama ene pushka s'ka projekt me ta. Mo shum kina dhan e kina mar me Pult (Kiri, Plani, Xhani). Shal e Shosh jena vllazni. Ma par u martojke Shal e Shosh, bile ene vet' bajraku mrena per mrena."*

\*

\* \*

Megjithë mungesën e traditës kërcyese, duhet të kujtojmë *gjamën* tradicionale, këtë "*valle mortore*" që Dukagjini njihet si një ndër vatrat kryesore, ku ai rit ka qenë praktikuar në vise të ndryshme të Shqipërisë së Veriut deri në prag të Luftës së Dytë Botërore.

Gjatë ekspeditës së vitit 1972 kemi zhvilluar biseda të shumta për *gjamën*, madje në praninë tonë është organizuar një e tillë, "*I mjeri u, miku em*", te cilën edhe e kemi inçizuar (Arkivi i Institutit të Kulturës Popullore-AIKP, bobina-bob. 877/21, fshati Breglum, viti 1972). Për këtë, kemi parasysh edhe filmimin "*Fragmente të gjamës*", që është interpretuar nga një grup burrash të Nikaj-Lekbibaj në Festivalin Folklorik të Tropojës, 1983 (AIKP, Kinofilmi-Kf. nr. 130/6). Ekezekutime të këtij riti kemi ndeshur në këto dhjetëvjeçarët e fundit nëpër festivalet folklorike kombëtare.

Si rrjedhojë e këtyre gjurmimeve, vërejmë se *gjama* është një mënyrë vajtimi që kryhej nga burrat. Përshkohej nga nota thellësisht tragjike që shprehnin dhembjen e madhe të shkaktuar nga vdekja e njeriut të afërm. Në të gërshëtohej mimika e zyrtë e plotë dëshpërim me lëvizjet e gjymtyrëve dhe të trupit, me grushtet që godisnin ritmikisht kraharorin, me hapa solemne në disa raste edhe me të gërvishura e të çjerra në fytyrë. Të gjitha këto krijonin një atmosferë të përmortshme. Njëri prej

pjesëmarrësve, gjamatari kryesor, improvizonte, ndërsa të tjerët përsërisnin veprimet e tij, duke e shoqëruar edhe me vargje e thirrma kuptimplote. Në këtë rit të lashtë duken qartë bulëzat plastiko-ritmike me përmbajtje koreografike deri në ato përmasa, sa ndonjëherë siç u theksua janë cilësuar si *"valle mortore"*.

Gjatë gjurmimeve punuam në Breglum me bartësin Gjergj Mark Lulashi, që njihej si rapsod, instrumentist dhe njohës i traditave kulturore të Dukagjinit. Ky na tregoi se nga burrat aty-këtu është praktikuar edhe ndonjë kërcim gjatë ceremonialit të dasmës, në kohën kur nusja nusëronte në shtëpi të dhëndrit në prani të burrave. Ky lloj kërcimi ose *"kcim dasme"*, siç e quante Gjergji, ka më tepër karakter argëtues dhe përshkohet nga elemente humoristike. Dhe, ka të ngjarë që një kërcim i tillë t'i përkasë periudhës së pas Luftës së Dytë Botërore.

Është interesant fakti se për këtë lloj kërcimi na ka dëshmuar edhe bartësja Prenaj Lulja, 53 vjeç, nga fshati Lotaj, martuar në Nica-Shosh. Nga njëra anë, ajo thotë se *"grat' nuk kan' kcy, as kan knu ner dasma; as dajren nuk e kan nije kurr' "*. Nga ana tjetër, Prenaj flet për kërcimin objekt, duke e përshkruar kështu: *"Nusja rrike n'kam tu burrat, me duvak deri nesre. Nji nga burrat kcejke, u shtremnukë, u bajke njashtu per loje, per t'bo qef n 'dasem. Me ket' qeshke gjith' mileti; nusja nuk qeshke, se ishte marre. Kcimi u bajke me çifteli. Femna kurr' nuk kcejke. Tashti n 'dasma kcejn' ma t'rejat"* (AIKP, bob. 898/2).

Sipas procedurës së punës sonë në terren, pas këtyre të dhënave dhe veçanërisht kur Gjergji na e demonstroi kërcimin, pamë se ai paraqiste mjaft interes, ndaj vendosëm që ta filmojmë. Aty improvizuam edhe një vajzë të mbuluar me duvak (Gjyste Martin Gila) dhe Gjergji kërceu para saj, duke e simbolizuar atë si partnere në rolin e nuses me duvak. Vallja u përcoll me çifteli nga Ded Nue Gila (AIKP, Kf. nr. 13/1, bob. 896/3).

Në vështrim të përgjithshëm, kërcimi shtjellohet me larmi motivesh dhe nuancash koreografike. Ai fillon qetë e lirshëm, mandej gjallërohet shkallë-shkallë. Nuk mungojnë rastet kur gjatë kërcimit valltari afrohet te *"nusja"* (që qëndron aty pranë me duvak mbuluar) për të prekur paksa duvakun, por pa e ngritur. Ose, nga gëzimi, në shenjë kënaqësie, valltari i bie ballit

me dorë, heq kapuçin e tij etj. Të gjitha këto bëhen që "nusja" të çlirohet nga "ndrydhja", që ta bëjnë atë dhe njerëzit përreth të qeshin. "Kërcim burrash para nuses", siç edhe mund ta quajmë, përbën një krijim koreografik popullor me një plastikë të zhdërvjellët dinamike. Ai bart elemente koreografike me karakter *ritual, humoristik dhe pantomimik*. Janë pikërisht këto tipare të qenësishme që e bëjnë këtë kërcim të përjetohet emocionalisht nga të pranishmit përreth, në raste dasmash, kur ai praktikohet më së shpeshti.

Në vazhden e këtij kërcimi, do të bëjmë objekt edhe një tjetër kërcim që është praktikuar nga burrat dhe që njihet me emrin "Kërcim shaljançe". Protagonist është valltari i shquar Lazer Bregu, 30 vjeç, nga fshati Breglum. Lazri thotë se këtë valle e ka mësuar nga Zef Maceli, 65 vjeç, prej të njëjtit fshat e që tani banon në Mamurras të Krujës. (Bëhet fjalë gjithmonë për kohën e ekspeditës, në vitin 1972). "Zefi, - tregon Lazri -, kcejke njo i vetem, sepse nuk kishte njerez tjer' qi dinin me kcye: ai kcejke n'dasma, si dhe kur ndodhke çoban me bagti dhe e lypkin çobant me kcye, ai kcejke me çiteli, ama ene pa çiteli".

Për veten e vet, ndonëse me fjalë të kursyera, Lazri tregon: "Qysh 10 vjeç kam marr pjesë nëpër dasma n'fshatra t'Shalës, si: Breglum, Abat, Pecaj, Theth, Nanmavriq, Mushaj etj; kam ken edhe në dasma t'Shoshit, Papsuj, Brasha e Shoshit, Moll t'Shoshit etj. Nëpër dasma ma fort kam kcye, por ene kam knue kang "maje krahi", kang "me putir" (të pijes, R.B). I bi ene çitelise, Kajden e kcimit e kam msue prej Mirash Zefit (i vdekun) ene Marash Nout".

Vallen objekt Lazri e luajti me mjeshtëri të rrallë. "K'tij kcimi i thon "Kcim shaljançe", dhe kur e kcejn dy veta - "kcim venit", - shton Lazri. Pas këtyre bisedave (AIKP, bob. 898/1), si edhe nga vetë kërcimi, u bindëm se kishim të bënim me një valle interesante. Ndaj edhe e filmuam, të përcjellë me çiteli nga Marash Nou.

Sipas filmimit të kësaj valleje, përmbajtjen ideoemocionale të kërcimit interpretuesi Lazer Bregu e shpreh me lëvizje plastike, të prera dhe me qëndrime burrërore. Vallja përfytyron një dialog midis madhështisë krenare të Alpeve, nga njëra anë, dhe monumentalitetit e solemnitetit të kërcimit, nga ana tjetër. Lëvizjet, motivet dhe figurat koreografike që luan kërcimtari,

rrjedhin natyrshëm, parapërgatitin njëra-tjetrën, janë të holla dhe nxjerrin bukurinë e vërtetë të valles, sepse tek interpretuesi nuk lëvizin vetëm gjymtyrët, por çdo peyzë e fibër e trupit dhe e ndërgjegjjes së tij artistike.

Nga pikëpamja e përcjelljes muzikore, të dyja vallet e analizuarra, "*Kërcim burrash para nuses*" dhe "*Kërcim shaljançe*", shoqërohen me çifteli, "*kan' vetëm ni kaide*", siç thonë vendasit. Kohët e vona, krahas çiftelisë, kërcimet shoqërohen edhe me fyej e zumare.

Duke iu referuar një lloj kërcimi më të vonshëm, gjatë ekspeditës hasëm një të tillë, i cili u ekzekutua nga bashkëshortët Shkurte Rushetja dhe Gjelosh Ara, që të dy të datëlindjes 1937, përkatësisht nga fshatrat Lekaj dhe Ndrecaj, banues në Breglum. Sipas një bisede me ta, një veprimtari e tillë më së shumti u përket atyre të shtëpive të kulturës, duke u përpjekur kështu të krijohet edhe njëfarë tradite folklorike. Vallën, të quajtur nga vetë bartësit "*Kërcim dyshe i vendit*", e filmuam nga të dy bashkëshortët. Ajo u përcoll muzikalisht me një formacion instrumentor: dy çifteli, një fyell, një zumare dhe një gjethe (AIKP, Kf. nr. 13/3). Ky lloj kërcimi, me përjashtim të ndonjë afrie kryesisht me ato të Malësisë së Madhe, ka krijuar në embrionin e vet edhe njëfarë fizionomie krahinore. Vallja e tyre përgjithësisht është e gjinisë liriko-erotike. Kërcimi ka formë të lirë në mënyrën e ekzekutimit të motiveve koreografike. Mbizotërojnë hedhjet pupthi mbi të dyja këmbët, gjysmërrotullimet valëzuese të trupit etj.; valltarët herë luajnë përballë njëri-tjetrit, herë bëjnë kryqëzime njëri me tjetrin dhe e përfundojnë kërcimin me të përqaftuar.

Veç valleve të mirëfillta, në Dukagjin, ashtu si në shumë krahina të Shqipërisë së Veriut, është praktikuar së tepërmi nga burrat edhe "*Loja e kapuçave*". Gjatë kërcimit të palës fituese të lojës, është karakteristike në Dukagjin se gjatë ekzekutimit të motivit të dyhapëshit popullor, "*lojtarët*" i ngrenë shumë këmbët përpara, mbi 90° dhe i nderin pothuajse fare të shtrira.

Kur flasim për vallëzimin popullor të Dukagjinit, nuk mund të mos kujtojmë lodrat me "*kacaleta*" (kukulla ose zogj), që vendasit i quajnë "*Kërcim kacaletash*". Një krijim të tillë patëm rastin ta filmonim me Kol Zef Kronin nga fshati Palaj, i cili është

edhe mjeshtër i të punuarit të *"kacaletave"*, njëherësh i njohur si ndër më të shquarit e kësaj loje në Dukagjin. Këto lodra, që vihen në lëvizje sikur kërcejnë, përdoren në disa krahina malore, kryesisht të Shqipërisë së Veriut. Për nga emërtimi, nga shtjellimi i lojës, numri i tyre, përcjellja muzikore e deri te mënyra e ndërtimit këto kukulla-zogj paraqiten në variante të ndryshme. Shoqërimi muzikor i lojës së tyre bëhet me çifteli. Secila pjesë e kukullave-zogj, që është vendosur mbi një platformë dërrase, lidhet me një fije peri me gishtërinjtë e dorës së djathtë të atij që i bie çiftelisë. Kur gishtërinjtë prekin telat e çiftelisë, *"kacaletat"* fillojnë të lëvizin duke imituar kërcimin e njerëzve. Vënia e tyre në lëvizje ngjall atmosferë të gëzueshme.

Në rastin e filmimit të *"Kërcim kacaletash"* nga Kol Zef Kroni (AIKP, Kf. nr. 13/4; bob. 896/4), luajnë tri *"kacaleta"*: një malësor e një malësore, me veshje dukagjinase, si edhe një grua qytetare, me veshje gjirokastrite. Sipas Kolës, *"kacaletën"* e tretë e ka konceptuar të tillë enkas për në Festivalin Folklorik Kombëtar - Gjirokastrë, 1969, domethënë para tre vitesh nga koha e regjistrimit tonë të asaj loje në Dukagjin. Në të gjitha rastet e tjera, siç ka qenë për shembull zhvillimi i herëpashershëm i festivalit të folklorit të rrethit të Shkodrës në fshatin Reç, ai i ka paraqitur të trija *"kacaletat"* me veshje dukagjinase. Kola tregon se loja e *"kacaletave"* imiton kërcimet vendase, çka e përforcon edhe melodia përcjellëse, e cila është e valleve dukagjinase, më saktë, afërsisht si dy vallet e para që u analizuan më lart.

\*  
\*   \*

Në përfundim, jemi të ndërgjegjshëm se përsa u përket valleve popullore, Dukagjini nuk është as Tropoja apo Kolonja, as Tirana apo Anamorava e Kosovës, as Librazhdi apo Labëria, as Malësia e Tetovës apo Konispoli i Çamërisë, as Dibra apo Myzeqeja... . Për të pohuar se në Dukagjin nuk ka traditë kërcimesh, do të ishte gjëja me e lehtë(!). Ne u përpoqëm të dëshmojmë të kundërtën, ama duke qenë të vetëdijshëm për t'i trajtuar ato njësi folklorike si *grimca* apo *gjurmë etnokoreografike*.